

**UNITED  
NATIONS**

United Nations  
Interim  
Administration  
Mission  
in Kosovo



**UNMIK**

**NATIONS UNIES**

Mission  
d'Administration  
Intérimaire des  
Nations Unies au  
Kosovo

**PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT**

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**Ligjislatura e dytë**

*Komisioni për Shëndetësi ,Punë  
dhe Mirëqenie Sociale  
Nr. 23/2007*

***PROCESVERBAL***

*i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, të mbajtur më  
10. 9. 2007, në sallën N-10 , në orën 13.00*

**Të pranishëm:** Fatmire Mulhaxha- Kollçaku,kryetare : Shpresa Murati, Nafije Berisha,  
Ilaz Pireva, Zylfije Hundozi, Rudina Bukoshi, Fehmi Vula,Zahrije Jusufi dhe Ferid  
Agani , anëtarë.

**Munguan :** Zllatica Kujunxhiq, Naim Jerliu, Flora Brovina, Teuta Hadri dhe Nurishahe  
Hulaj .

**Moren pjesë :**

**Edgardo Ruggiero** nga Fondi Monetar Ndërkombëtar

- Fadil Gashi këshilltar i ministrit për Punë dhe Mirëqenie Sociale
- Fadil Rraci - Ministria e Punës dhe Mirëqenie Sociale dhe
- Gjylnaze Gola Ministria e Punës dhe Mirëqenie Sociale.

Mbledhjen e drejtoi **Fatmire Mulhaxha – Kollçaku** dhe propozoi këtë:

***REND DITE***

- 1. Takim me ministrin z. Ibrahim Selmanaj dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar lidhur me Projektligjin e punës ,**

2. **Shqyrtimi i Projekt udhëzimit administrativ për themelimin ,përberjen dhe funksionimin e Këshillit të Përgjithëshëm Profesional**
3. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes se kaluar,**
4. **Të ndryshme**

Komisioni u pajtua në mungesë të ministrit të marrin pjesë këshilltari i tij dhe dy zyrtaret ligjor

**Rendi i ditës u miratua .**

**U hap shqyrtimi për pikën e parë**

**1 Takim i Komisionit me z. Edgardo Ruggiero nga Fondi Monetar Ndërkombëtar lidhur vërejtjet e dhëna ne Projektligjin e punës**

**Fatmire Mulhaxha –Kollçaku,** pasi e përshëndeti përfaqësuesit e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale. ndër të tjera ceku : Qëllimi i takimit është që Komisioni për se afërmi të njoftohet lidhur me implikimeve buxhetore që përmban Projektligji i punës . Projektligji është i rëndësishmi për punëtorët e Kosovës dhe në kuadrin e tij ka me se 15 projektligje .

**Z Edgardo Ruggiero** lidhur me Projektligjin e punës tha se ka disa vërejtje të cilat kanë të bëjnë me implikime buxhetore . Pra, sipas metodologjisë çdo Projektligji duhet t'i ketë vlerësimet financiare . Në vlerësimet e MPMS dhe Ministrisë se Financave vërehen dallime , . Njëra Ministri deklaroi se kosto financiare kap shumen prej 13,milion euro ,kurse tjetra thotë 23 milion euro. Projektligjit të punës megjithatë , i mungon koncepti,nga se nuk janë dhënë shpjegime për fushat që rregullon. Po ashtu, përmban të meta, që nga dispozitat e nenit 1 . Këto të mangësi që ka projektligji është dashur t'i shqyrtojë Qeveria para se të arrijë në Kuvend. Ai në përgjithësi i paraqiti vërejtjet ku Projektligji ndeshet me implikimet buxhetore dhe shtoi: Projektligji i ofruar nuk është ne pajtueshëmeri me direktivat e ligjslacionit Unionit Evropian dhe i sugjeroi Komisionit që ky projektligj dhe ata qe kanë bëjnë metë me ketë të mos i miratojë Kuvendi i Kosovës .Njëkosisht dizopzitat e tij paraqesin pengesë për investitorët e jashtëm.

**Ferid Agani** pyeti -Si është të ketë mangësi ky P/l kur kjo Ministri ishte ne kontakt me Fondin Monetar Ndërkombëtar

**Fadil Gashi** – këshilltar i ministrit nuk u pajtua me vlerësimet e dhëna nga **Edgardo Ruggiero**

**Fadil Rraci** – në vazhdim nuk u pajtua me disa deklarimet të ekspertit dhe ne ketë kontekst nënvizoi- se Projektligji në fjalë është në përputhje me ligjslacionin evropian. Vlerësimet lidhur me Projektligjin e punës janë dhënë ne momerandumi shpjegues. Pra, sipas tij, kontestues është vetëm neni 62 i cili e rregullon shpenzimet e udhëtimit . Ai duke iu përgjigjur nënvizoi se korniza ligjore nuk ka ekzistuar fare ne kohen e hartimit të

tij ,kështu qe për këtë ekziston letra e qëllimit të mirë qe ka të bej me skemat e ndihmës sociale. Ai ne vazhdim foli për përmbajtjen e tij dhe me ligjet tjera .

**Nafije Berisha** duke u ndërlidhur me parafolësit lidhur me Projektligjin e punës ceku se Kosovës i duhet ligji përkatës, duke ua siguruar të drejtat qe burojnë nga mardhaja e punës. Ajo ceku se ka mundësi të përpunohet dhe të behet shkurtim i pjesëve te tij sa për i përket zvogëlimit të kostos buxhetore . Në fund pyeti - A ka Fond. Mon. Nderk. ndonjë vlerësim lidhur me shtimin e vendeve të punës . Pra , a ka vlerësim FMN se deri ku do të shkojë varfria në Kosovë ?

Pyetje parashtruan Ferid Agani etj kurse atyre iu përgjigj Z . **Edugardo Ruggiero Fadil Rraci** -në fjalën e serishme nuk u pajtua me diskutimin e parafolësit lidhur me pajtueshmëri me ligjesalcionin Evropian . Ai diskutimin e mbështet në deklaratën e Zyrës për Integritet .

**Gjylnaze Gola** u pajtua me parafolësin dhe paraqiti arsyetimet rreth hartimit të Projektligjit në vija të trasha . Ajo pjesërisht u pajtua me mendimin e përfaqësuesit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të paraqitur në këtë projektligj .

**Fatmire Mulhaxha** kërkoi caktimin e takimit të përbashkët të Komisionit me Fondin Monetar Ndërkombëtar ku do të diskutonin lidhur me Ligjin për sigurime shëndetësore Ishte i konstatim i përgjithshëm i anëtareve që Komisioni lidhur me Projektligjin e punës të marrë qëndrim rreth mënyrës se procedimit të tij, pasi që ka siguruar informacione nga Fondi Monetarë Ndërkombëtar.

## **U hap shqyrtimi për pikën e dytë**

### **2 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes se kaluar,**

Pasi nuk pati vërejtje ,u miratua .

Kryetarja i propozoi Komisionit të vazhdohet me këtë rend dite në mbledhjen ardhshme me shqyrtimin e pikave pika 3 dhe 4 pasi anëtarët e Komisionit ishin të lodhur . Me propozimin e asaj u pajtuan të pranishmit .

Mbledhja përfundoi në orën 13,40

Procesmbajtës,  
Rrahim Demaj – zyrtar i lartë ligjor

**Kryetarja e Komisionit  
Fatmire Mulhaxha- Kollçaku**